REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 796/7 prot. Tiranë, më 02 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 267, datë 02 . 10 . 2026

Mbështetur në nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar (në vijim LMD), pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi[1] është regjistruar ankesa nr. 102 Regj., datë 23.04.2026, paraqitur nga z. A. K, nëpërmjet përfaqësueses së tij ligjore, av. L. D, kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz, për shkak të "*përgjegjësisë prindërore*", "*gjendjes familjare*", "*gjendjes martesore*" dhe "*gjendjes civile*".

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Z. A. K dhe znj. R. D (K) janë martuar në vitin 2017 dhe kanë një vajzë, E. K (lindur më 01.12.2017), e cila është nxënëse në klasën e dytë në Shkollën 9-Vjeçare "Vllazërimi", Kamëz.
Gjykata e Rrethit Dibër (Vendimi nr. 14, datë 16.01.2020) dhe Gjykata e Apelit (Vendimi nr. 581, datë 02.06.2025) kanë vendosur zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim nënës, pagesën e pensionit ushqimor nga babai, si dhe kanë rregulluar takimet fizike dhe komunikimet javore elektronike të babait me vajzën.

Gjatë vitit shkollor 2024-2025, ankuesi kishte akses të plotë në platformën zyrtare digjitale SMIP. Në tetor 2025, ai zbuloi se aksesi i ishte ndërprerë, situatë që vijon gjatë gjithë vitit shkollor 2025-2026

Ankuesi ka kërkuar zgjidhje verbale dhe me shkrim pranë Shkollës dhe ZVA Kamëz (përfshirë email-e më 05.12.2025 dhe 04.02.2026), por institucionet fillimisht u shmangën duke u arsyetuar verbalisht se *"ka ndryshuar formati i aplikacionit"* dhe nuk dhanë asnjë përgjigje zyrtare.
Në përgjigjen me shkrim të datës 16.04.2026, shkolla deklaroi zyrtarisht se aksesi në SMIP i është ndërprerë që prej datës së vendimit të Apelit (02.06.2025) pasi z. K *"nuk ka kujdestarinë ligjore"* dhe sistemi nuk pranon prindin që nuk ka kujdestari.

Ankuesi pretendon se ndërprerja e aksesit është bërë vetëm për shkak të ndryshimit të statusit të tij nga "i martuar" në "i divorcuar", gjë që përbën trajtim të pabarabartë dhe diskriminim flagrant.
Ai thekson se zgjidhja e martesës nuk ia heq apo kufizon përgjegjësinë prindërore. Asnjë vendim gjykate nuk ia ka ndaluar interesimin për arsimimin e vajzës apo aksesin në SMIP.
Shkolla ka hyrë në çështje që u takojnë gjykatave apo përmbarimit, duke dështuar në detyrën e saj parësore: informimin e prindit mbi ecurinë mësimore.
Ankuesi ka dërguar ankesa (më 16.04.2026) pranë MAS, AKAP, DRAP Tiranë dhe ZVA Kamëz. Ai pretendon se këto institucione, me indiferencën dhe mosveprimin e tyre, po lejojnë këtë praktikë abuzive duke u bërë palë në diskriminim.
Në kushtet kur marrëdhënia me ish-bashkëshorten ia pamundëson informimin e drejtpërdrejtë, SMIP mbetet burimi i vetëm ligjor që ai të mos përjashtohet nga jeta dhe edukimi i vajzës së tij.

Ankuesi pretendon se, ndërprerja e aksesit të babait në sistemin SMIP për shkak të statusit të tij si prind i divorcuar, nënkupton një trajtim të pabarabartë të bazuar në gjendjen familjare/martesore/civile/përgjegjësinë prindërore, dhe se, veprimet dhe mosveprimet e institucioneve përkatëse (shkollës, MAS, AKAP, DRAP Tiranë dhe ZVA Kamëz) përbëjnë diskriminim dhe cenim të të drejtave të ligjshme të babait.

Masat që kërkohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër të tjera janë:

"Konstatimi i diskriminimit nga na e ZVAP Kamëz ndaj A. K për shkak të përgjegjësisë prindërore, gjendjes familjare, gjendjes martesore, gjendjes civile.
Urdhërimi i ZVAP Tiranë për marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar dhe rikthyer aksesin e A. K në SMIP, si e drejtë legjitime për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së tij E. K."

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji nr.10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Në nenin 1 të LMD parashikohet

se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: "*Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".*

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me objektin e ankesës dhe pretendimin e ankuesit për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32 dhe 33 të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 798/1 prot., datë 07.05.2026, Komisioneri i ka kërkuar ankuesit paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit shtesë lidhur me komunikimet e zhvilluara me institucionet e paditura.

2. Me shkresën nr. 796/1 prot., datë 24.04.2026, ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit informacion dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të ankesës[1].

[1] Janë depozituar në dosjen e ankuesit pranë KMD-së dhe konsiderohet pjesë integrale e saj, të gjitha parashtrimet e dokumentat e dërguara edhe nëpërmjet e-mailit.

3. Me shkresën nr. 796/2 prot., datë 07.05.2026, Komisioneri ka njoftuar ZVAP Kamëz, duke i kërkuar informacion e parashtrime me shkrim lidhur me pretendimet e ngritura nga nakuesi.

- Me shkresën nr. 673/1 prot., datë 20.05.2026, ZVAP Kamëz, informon Komisionerin, ndër të tjera lidhur me pretendimet e ankuesit, objekt i kësaj ankese dhe që kanë të bëjnë me mospasjen e aksesit të tij në sistemin SMIP, gjatë vitit shkollor 2025-2026[2].

Në këtë kuadër, ZVAP Kamëz informon se, lidhur me ankesën e z. K për mungesën e aksesit në SMIP, (paraqitur nëpërmjet e-mailit datë 16.04.2026 nga përfaqësuesja e tij ligjore, Av. L. D), nëpërmjet emailit datë 22.04.2026, i është bërë me dije se, *sistemi SMIP i gjeneron të dhënat nga databaza e Gjendjes Civile, (pra të dhënat gjenerohen nga e-Albania. Aksesi i z. K në SMIP është ndërprerë automatikisht nga sistemi dhe Shkolla apo ZVAP nuk ka akses të ndërhyjë. Gjithashtu i është bërë me dije se Shkolla disponon një vendim gjyate ku kujdestari ligjor i fëmijës është mamaja e saj.*

4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 796/4 prot., datë 01.07.2026, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, duke iu bërë të ditur se, secila prej tyre mund të depozitojë gjatë seancës, shpjegime si dhe dokumentacion provues në favor të argumentave të veta.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 20.07.2026, vetëm me praninë e subjektit ankues dhe përfaqësuesë së tij ligjore., Av. L. D, në mungesë të përfaqësuesve të ZVAP Kamëz (si dhe të DRAP Tiranë, të cilët ishin ftuar për të marrë pjesë në këtë seancë)

Pala ankuese i qëndroi të njëjtave parashtrime e argumenta si ato të bëra të njohura shkresërisht në korrespondencën shkresore me KMD-në, të cilat do të shtjellohen gjatë arsyetimit të vendimit.

5. Me shkresën nr. 796/6 prot., datë 22.07.2026, Komisioneri i ka përcjellë për njohje ZVAP Kamëz dhe DRAP Tiranë (duke qenë se nuk ishin të pranishëm në seancë) kopjen audio të seancës dëgjimore, duke kërkuar që në funksion të garantimit të parimeve të transparencës, kontradiktoritetit, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, të paraqesin me shkrim qëndrimin, kundërshtimet, shpjegimet dhe provat lidhur me pretendimet e ngritura nga pala ankuese, brenda 10 ditëve nga komunikimi i shkresës.

Pavarësisht mundësisë së dhënë dhe njoftimit të përsëritur, brenda afatit të përcaktuar ZVAP Kamëz dhe DRAP Tiranë nuk paraqitën parashtrime apo prova të tjera shtesë.

[2] Parashtrimet e ZVAP Kamëz i janë përcjellë për njohje përfaqësueses ligjore të subjetit ankues nëpërmjet e-mailit.

Në këto kushte, duke vlerësuar se palëve u është garantuar në mënyrë të plotë mundësia për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur qëndrimet dhe provat e tyre, Komisioneri vijoi me përfundimin e hetimit administrativ dhe marrjen e vendimit mbi bazën e akteve dhe provave të administruara në dosje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë proçesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të z. A. K nga ana e ZVAP Kamëz

Bazuar në provat e administruara, rezultoi e provuar se ankuesi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të pandërprerë përgjegjësinë prindërore ndaj vajzës së tij, përfshirë aksesin e rregullt në SMIP gjatë periudhës kur figuronte "i martuar", dhe se ky akses është ndërprerë më datë 02.06.2025, datë kur vendimi gjyqësor për divorcin mori formë të prerë.

- *Kuadri ligjor dhe standardet e zbatueshme.*

Sistemi SMIP është krijuar si bazë e të dhënave shtetërore në kuptim të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 *"Për bazat e të dhënave shtetërore"*, me VKM-në nr. 742, datë 03.12.2021, *"Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të SMIP"*, e ndryshuar, dhe rregullohet nga Rregullorja për Përdorimin e SMIP, miratuar me urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, të MAS-it, e ndryshuar.

Bazuar në nenin 3, shkronja "b", të ligjit nr. 10 325/2010, *"Subjekt i interesuar"* kuptohet *"çdo person fizik ose juridik, të cilit i lejohet të aksesojë bazën e të dhënave shtetërore"*. VKM-ja nr. 742/2021, në pikën 8, shkronja "g", sanksionon se: *"prindërit shohin të dhënat e fëmijës/fëmijëve së/të regjistruar në sistem si nxënës (ecurinë në shkollë)"* në shumës, jo "prindi kujdestar".

Rregullorja SMIP, në nenin 3, pika 13, e quan këtë kategori "*Aksesi i personit që ushtron përgjegjësinë prindërore*", e përcaktuar si *"Personi/personat që, sipas legjislacionit në fuqi, ushtrojnë përgjegjësitë prindërore për fëmijën…"*. Vetë neni 15 i Rregullores, të cilin shkolla e ka cituar në shpjegimet e saj, e titullon këtë të drejtë "*Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore*", jo "personi që ka kujdestarinë ligjore".

Neni 7, i kësaj Rregulloreje përcakton se ZVAP ushtron përgjegjësitë, ndrë të tjera, duke cituar se: *"1. Përgjigjet për menaxhimin e të dhënave të shkollave në varësi në kuadër të SMIP-it. Kjo përfshin krijimin e rekordeve të shkollave, ndryshimin e të dhënave të tyre dhe çaktivizimin e tyre, nëse ndodhin ndryshime të tilla.*
...6. Orienton, këshillon, mbështet dhe mbikëqyr adiministratorët e SMIP-it për procese të punës në sistem....10. Mbështet dhe asiston administratorin e SMIP-it në shkollë për problematikat e funksionimit të SMIP-it dhe për zgjidhjen e secilës prej tyre. 11. Koordinon punën me suportSMIP për zgjdhjen e problemeve teknike të funksionimit të sistemit në shkollat në juridiksion....13. Harton

raporte, studime dhe analiza për funksionimin e SMIP-it në nivel lokal dhe i dërgon ato në DRAP, duke dhënë rekomandime, propozime, sugjerime, etj.
...15. Orienton, trajnon dhe mbështet administratorët e shkollave në juridiksion për plotësimin në kohë dhe me saktësi të SMIP-it...”

Në po të njëjtën linjë, Urdhri i MAS-it nr. 71, datë 19.02.2025, neni 16/1 “Fletorja e komunikimit digjital”, i cituar gjithashtu nga vetë Shkolla, e kufizon aksesin në fletët informuese “vetëm personit që ushtron përgjegjësinë prindërore” përsëri, jo kujdestarit ligjor.

Pra, rezulton se se kriteri i vetëm ligjor, i vendosur nga ligji, VKM-ja, Rregullorja SMIP dhe vetë Urdhri i MAS-it, është *ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, jo mbajtja e kujdestarisë ligjore*. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi vetë shpjegimet e ZVAP Kamëz, të paraqitura pranë Komisionerit, citojnë njëkohësisht të dyja këto akte (*që flasin për “përgjegjësi prindërore*”) dhe, në të njëjtën kohë, mbështesin vendimin e saj mbi kriterin e “*kujdestarisë ligjore*” një kriter që nuk përmendet as edhe një herë në tekstin e këtyre akteve si kusht aksesimi.

- *Mbi pretendimin e ZVAP Kamëz se ndërprerja ka qenë “veprim automatik i sistemit dhe Shkolla apo ZVAP nuk ka akses të ndërhyjë”.*

Komisioneri evidenton faktin se, krahas kësaj ankese, z. K ka depozituar edhe ankesën nr. 104 Regj., datë 23.04.2026, paraqitur nga z. A. K, kundër Shkollës 9-vjeçare “Vëllazërimi”, me pretendimin për diskriminim lidhur me heqjen e aksesit në SMIP, për shkak të “*përgjegjësisë prindërore*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*” dhe “*gjendjes civile*”. Në përfundim të shqyrtimit të saj, Komisioneri është shprehur me Vendimin nr. 234, datë 19.08.2026[3].

Në analizën e bërë lidhur me pretendimet e z. K, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, *z. A. K është vënë në një situatë të qartë diferencimi në trajtim, në raport me prindin tjetër, lidhur me ushtrimin e të drejtës së tij prindërore për informim, pasi, ndryshe nga prindi tjetër, atij i është ndërprerë aksesi në SMIP dhe i është mohuar mundësia për të marrë informacion mbi ecurinë shkollore të fëmijës, çka përbën, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Vëllazërimi”, trajtim të pabarabartë dhe të pafavorshëm ndaj ankuesit, në kuptim të nenit 3, pika 2, të LMD-së.*

... pretendimi i shkollës sipas të cilit ndërprerja e aksesit të ankuesit ka qenë “veprim automatik” i sistemit, “jo rezultat i një veprimi të drejtpërdrejtë” të institucionit, nuk gjen mbështetje në faktet dhe as në sqarimet e autoritetit teknik kompetent. Ndërprerja e aksesit të ankuesit, për rrjedhojë, ka

[3] Komisioneri është shprehur me Vendimin nr. 234, datë 19.08.2026, nëpërmjet të cilit ka konstatuar diskriminim e ankuesit z. A. K nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Vëllazërimi”, Tiranë, për shkak të “përgjegjësisë prindërore”, “gjendjes familjare”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes civile”, dhe ka bërë urdhërimet përkatëse.

qenë rezultat i një veprimi apo mosveprimi konkret, brenda sferës së përgjegjësisë administrative të vetë shkollës, si institucion administrues i të dhënave në SMIP.

Sa më sipër, pavarësisht faktit se, Komisioneri ka konstatuar se institucioni që mban përgjegjësinë kryesore për administrimin e të dhënave të sistemit SMIP është Shkolla, nisur nga detyrimet dhe përgjegjësitë që Rregullorja për Përdorimin e SMIP, i ngarkon ZVAP-së, në rastin në fjalë, ZVAP Kamëz mban përgjegjësi për mosveprimin e saj për marrjen e masave në bashkëpunimin me Shkollën për rregullimin e situatës, duke i rikthyer ankuesit të drejtën e aksesit në SMIP. ZVAP Kamëz njëlloj si Shkolla ka keqinterpretuar vendimin gjyqësor, duke argumentuar se ankuesi nuk ishte kujdestar ligjor i fëmijës dhe për pasojë nuk kishte të drejtë aksesi në SMIP.

Bazuar në kompetencat e saj ZVAP Kamëz duhet të kishte ndërhyrë duke orientuar, këshilluar drejt dhe mbështetur administratorin e shkollës lidhur me rikthimin e aksesit të tij në SMIP. Edhe në rast se ZVAP nuk mund të zgjidhte apo urdhëronte drejtpërdrejtë adminsitratorin e SMIP, për rikthimin e aksesit të z. K në SMIP, për shkak të ndonjë problemi teknit të krijuar nga vetë sistemi, ajo sërish nuk e ka përcjellë a raportuar në suportSMIP, si problematikë që kërkon zgjidhje.

Përkundrazi, Komisioneri thekson faktin se, ZVAP Kamëz ka mbajtur të njëjtin qëndrim me Shkollën sa i përket shpjegimeve të dhëna për heqjen e aksesit të ankuesit nga SMIP (se *aksesi i i z. K në SMIP është ndërprerë automatikisht nga sistemi dhe Shkolla apo ZVAP nuk ka akses të ndërhyjë. Gjithashtu i është bërë me dije se Shkolla disponon një vendim gjykate ku kujdestari ligjor i fëmijës është mamaja e saj),* duke bërë që me mosveprimin e saj ankuesit t'i mohohej e drejta e aksesit në SMIP, për marrjen e informacioneve lidhur frekuentimin dhe rezultatet në procesin mësimor të vajzës së tij.

Komisioneri arrin në përfundimin se z. A. K është vënë në një situatë të qartë diferencimi në trajtim, në raport me prindin tjetër, lidhur me ushtrimin e të drejtës së tij prindërore për informim, pasi, ndryshe nga prindi tjetër, atij i është ndërprerë aksesi në SMIP dhe i është mohuar mundësia për të marrë informacion mbi ecurinë shkollore të fëmijës, çka përbën, nga ana e ZVAP Kamëz, trajtim të pabarabartë dhe të pafavorshëm ndaj ankuesit**.**

Në përgjigjen e saj të datës 03.07.2026, AKSHI institucioni ligjërisht përgjegjës për administrimin teknik të infrastrukturës dhe zhvillimin e SMIP ka sqaruar shprehimisht se ndryshimi i gjendjes civile *"nuk sjell automatikisht ndryshimin e të drejtave të aksesit në SMIP"*, se platforma e-Albania *"nuk kryen dhe nuk disponon funksionalitete që mundësojnë heqjen automatike të aksesit"*, dhe se vendimet mbi shtimin apo heqjen e kujdestarëve ligjorë *"trajtohen nga institucionet përgjegjëse"*, jo nga vetë platforma.

Kjo do të thotë se pretendimi i shkollës i përsëritur si tek shpjegimet e datës 13.05.2026 (nr. 75 prot.), ashtu edhe tek ai i datës 15.07.2026 (nr. 92 prot.) sipas të cilit ndërprerja e aksesit të ankuesit ka

qenë "*veprim automatik*" i sistemit, "*jo rezultat i një veprimi të drejtpërdrejtë*" të institucionit, nuk gjen mbështetje në faktet dhe as në sqarimet e autoritetit teknik kompetent. *Ndërprerja e aksesit të ankuesit, për rrjedhojë, ka qenë rezultat i një veprimi apo mosveprimi konkret, brenda sferës së përgjegjësisë administrative të vetë shkollës, si institucion administrues i të dhënave në SMIP*

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga pala ankuese, si vijon:

"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, *identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkaku i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasja gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

B.1. Përgjegjësia prindërore.

Ankuesi e mbështet këtë shkak me faktin se vendimet gjyqësore nr. 14/2020 dhe nr. 581/2025 i njohin atij, si prind, të drejta konkrete e të pandryshuara (takim, komunikim, pushime), pa asnjë kufizim apo heqje të përgjegjësisë prindërore. Prova vendimtare e lidhjes me këtë shkak është vetë deklarimi i shkollës (16.04.2026), i cili e konteston shprehimisht cilësinë e ankuesit si prind me të drejta aksesi, në kundërshtim të hapur me faktet e njohura nga vetë gjykata, dhe në kundërshtim edhe me tekstin e vetë akteve (Rregullorja SMIP, Urdhri i MAS nr. 71/2025) që shkolla citon në mbrojtje të vet, të cilat flasin shprehimisht për "përgjegjësi prindërore", jo "kujdestari ligjore".

B.2. Gjendja familjare.

Gjendja familjare e ankuesit ka ndryshuar që prej ndarjes faktike (shtator 2019) nga familje e bashkuar në familje të ndarë. Ai e mbështet këtë shkak duke provuar se trajtimi i pafavorshëm (ndërprerja e aksesit) filloi ekzaktësisht kur ky ristrukturim i familjes u formalizua përfundimisht me vendimin e Apelit, çka tregon se ishte pikërisht ky ndryshim i strukturës familjare ai që shkaktoi reagimin e shkollës.

B.3. Gjendja martesore.

Gjendja martesore e ankuesit ndryshoi zyrtarisht nga "i martuar" në "i divorcuar" me marrjen formë të prerë të vendimit të Apelit më 02.06.2025. Prova më e drejtpërdrejtë e lidhjes me këtë shkak është koincidenca e plotë kohore mes datës së ndërprerjes së aksesit dhe datës kur vendimi i divorcit u finalizua, si dhe fakti që vetë shkolla, në më shumë se një përgjigje zyrtare, e ka lidhur shprehimisht ndërprerjen me "vendimin e Gjykatës" dhe me humbjen e "kujdestarisë" pas divorcit.

B.4. Gjendja civile.

Gjendja civile e ankuesit statusi i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile ndryshoi njëkohësisht me zgjidhjen e martesës. Vetë ZVA Kamëz, në email-in e datës 22.04.2026, e lidh shprehimisht çështjen me faktin se "sistemi SMIP i gjeneron të dhënat nga databaza e gjendjes civile". Siç u provua në pikën "A" (referuar sqarimit zyrtar të AKSHI-t), ky pretendim është faktikisht i pasaktë por vetë përdorimi i tij nga institucionet e arsimit, si arsyetim për kufizimin e aksesit, provon në mënyrë të drejtpërdrejtë se ishte pikërisht gjendja civile e ndryshuar e ankuesit ajo që u mor si shkak (edhe pse gabimisht) i trajtimit të pafavorshëm ndaj tij.

Sa më sipër, shkaqet: "*përgjegjësisë prindërore*", "*gjendjes familjare*", "*gjendjes martesore*" dhe "*gjendjes civile*", janë shkaqe që parashikohen në mënyrë të drëjtëpërdrejtë nga LMD si shkaqe që gëzon mbrojtje nga diskriminimi dhe se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri vlerëson se, rezultoi plotësisht e provuar ekzistenca e tyre.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *"1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive".*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 50 të Kushtetutës.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *"a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës disckrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik"*.

Ligji "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme[4].
Sipas nenit 3, pika 1 të LMD diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pikat 2 dhe 15, të LMD, përcaktohet se: *"2. "Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji……*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. *(Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston

[4] Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet[5]. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme[6]. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si "dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme" dhe "bazuar në një karakteristikë ose "status" të dallueshëm""[7]

Në të njëjtën frymë edhe në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *"Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi".*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : "*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*."

Referuar Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, është parashikuar si vijon : *"2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj."*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka

[5] Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.
[6] Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

[7] S*hih: Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin[8].
Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *"të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave…provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.".*[9] Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.GJEDNJ shprehet se: *"..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndaren e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.".*[10]

[8] https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.
[9] GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.
GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.
[10] GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.
GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: *"....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi."*

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

(i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;

(ii) shkaku i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një "shkak i mbrojtur" sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

(iii) dhe arsyeja për këtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, në rastin konkret, ankuesi ka pretenduar se trajtimi i pafavorshëm ndaj tij ka ardhur për shkak të "përgjegjësisë prindërore", "gjendjes familjare", "gjendjes martesore" dhe "gjendjes civile". Komisioneri vlerëson se këto janë shkaqe të mbrojtura shprehimisht nga neni 1 i LMD-së. Në këtë drejtim, duhet të mbahet në konsideratë se ligji nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" të ndryshuar.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes rezulton se ankuesi, përpara datës 02.06.2025, kishte akses në sistemin SMIP dhe e ushtronte këtë akses për t'u informuar mbi ecurinë shkollore të vajzës së tij. Po kështu, rezulton e provuar se ky akses është ndërprerë pikërisht më datë 02.06.2025, datë në të cilën vendimi nr. 581 (30-2025-4760), datë 02.06.2025, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka marrë formë të prerë. Pas kësaj date, ankuesi nuk ka pasur më akses në SMIP, ndonëse nuk rezulton se ndaj tij është marrë ndonjë vendim gjyqësor që të ketë hequr apo kufizuar përgjegjësinë e tij prindërore ndaj fëmijës.

Ky fakt është veçanërisht i rëndësishëm për përcaktimin e lidhjes shkakësore, pasi ndryshimi në trajtimin e ankuesit nuk ka ndodhur në një moment të rastësishëm, por menjëherë pas finalizimit të zgjidhjes së martesës. Ankuesi kishte akses në sistem gjatë kohës kur figuronte i martuar, ndërsa aksesi iu ndërpre në të njëjtën datë kur vendimi gjyqësor për zgjidhjen e martesës mori formë të prerë dhe gjendja e tij familjare, martesore dhe civile ndryshoi. Kjo përputhje kohore, e vlerësuar së bashku me provat e tjera të administruara, përbën një tregues të rëndësishëm për lidhjen ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkaqeve të pretenduara të diskriminimit.

Lidhja me shkakun e mbrojtur bëhet edhe më e drejtpërdrejtë nga vetë qëndrimi i subjektit të paditur. Në përgjigjen e datës 22.04.2026, ZVAP Kamëz ka deklaruar se aksesi i z. K në SMIP është ndërprerë më datë 02.06.2025, pasi ai "*nuk ka kujdestarinë ligjore të fëmijës së tij*", duke shtuar se të drejtën për të hyrë në sistem e ka vetëm prindi që ka kujdestarinë ligjore. Pra, vetë subjekti kundër të cilit është bërë ankesa e ka lidhur trajtimin e ankuesit me pozitën e tij juridike pas zgjidhjes së martesës dhe me faktin se fëmija i është lënë nënës për rritje dhe edukim.

Në këtë pikë, Komisioneri çmon se duhet bërë dallimi ndërmjet "*përgjegjësisë prindërore*" dhe "*kujdestarisë ligjore*", pasi këto dy koncepte nuk mund të përdoren si të barasvlershme për të justifikuar kufizimin e të drejtave të ankuesit.

Nga vendimet gjyqësore të administruara në dosje nuk rezulton që ankuesit t'i jetë hequr ose kufizuar përgjegjësia prindërore. Përkundrazi, vendimi nr. 581 (30-2025-4760), datë 02.06.2025, i Gjykatës së Apelit, krahas lënies në fuqi të vendimit të shkallës së parë, i ka njohur ankuesit të drejtën për të marrë fëmijën gjatë periudhave të caktuara, për pushimet dimërore e verore, si dhe të drejtën për të komunikuar me të nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Këto të drejta janë elemente konkrete të marrëdhënies prind-fëmijë dhe tregojnë se gjykata nuk ka vendosur një përjashtim të ankuesit nga ushtrimi i përgjegjësisë prindërore.

Ky përfundim gjen mbështetje edhe në aktet që rregullojnë funksionimin e SMIP-it. Rregullorja për Përdorimin e SMIP-it, miratuar me urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, përdor konceptin "*personi që ushtron përgjegjësinë prindërore*" si kategori që lidhet me të drejtën e aksesit në sistem. Në të njëjtën mënyrë, Urdhri nr. 71, datë 19.02.2025, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, në dispozitat që rregullojnë fletoren e komunikimit digjital, i referohet personit që ushtron përgjegjësinë prindërore. Pra, kriteri i përdorur nga këto akte është ushtrimi i përgjegjësisë prindërore dhe jo, në mënyrë të posaçme, posedimi i kujdestarisë ligjore.

Në këtë kontekst, pretendimi i ZVAP-së se ankuesi nuk mund të kishte akses në SMIP vetëm për shkak se fëmija nuk i ishte lënë atij për rritje dhe edukim nuk rezulton të mbështetet në një dispozitë konkrete të akteve që rregullojnë sistemin. Përkundrazi, ZVAP-ja ka përdorur termin "*kujdestari ligjore*" si kriter kufizues, ndërkohë që aktet rregulluese të SMIP-it i referohen personit që ushtron përgjegjësinë prindërore. Për rrjedhojë, diferencimi i bërë ndaj ankuesit nuk rezulton të jetë thjesht rezultat i një rregulli teknik neutral, por i mënyrës se si është përcaktuar dhe zbatuar statusi i tij prindëror pas zgjidhjes së martesës.

Pretendimi tjetër i ZVAP-sëse ndërprerja e aksesit ka ardhur në mënyrë automatike nga sistemi nuk e ndryshon këtë përfundim. Përkundrazi, ky pretendim nuk përputhet me informacionin zyrtar të dhënë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si institucioni përgjegjës për administrimin teknik të infrastrukturës së sistemit[11]. Në përgjigjen e datës 03.07.2026, AKSHI ka sqaruar se ndryshimi i statusit civil të një shtetasi, përfshirë ndryshimin nga "i martuar" në "i divorcuar", nuk sjell automatikisht ndryshimin e të drejtave të aksesit në SMIP; se platforma e-Albania nuk disponon funksionalitete për heqjen automatike të aksesit në SMIP; si dhe se shtimi ose heqja e kujdestarëve ligjorë trajtohet nga institucionet përgjegjëse dhe nuk është kompetencë e platformës e-Albania.

Për rrjedhojë, Komisioneri çmon se nuk mund të pranohet si shpjegim objektiv dhe neutral pretendimi se humbja e aksesit ishte pasojë automatike e ndryshimit të të dhënave në sistem. Përkundrazi, nga provat e administruara rezulton se ndryshimi i statusit civil nuk prodhon vetvetiu humbjen e aksesit dhe se përcaktimi i personave që kanë të drejtë të aksesojnë të dhënat e nxënësit trajtohet nga institucionet përgjegjëse. Kjo e bën të nevojshme që veprimi ose vendimmarrja konkrete që ka sjellë ndërprerjen e aksesit të vlerësohet pikërisht në raport me kriterin mbi bazën e të cilit ankuesi është trajtuar ndryshe.

Komisioneri çmon se, nëse ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe vetëm për shkak të një kufizimi teknik të sistemit, një kufizim i tillë do të duhej të zbatohej në mënyrë neutrale dhe për nënën e fëmijës pasi statusi ka ndryshuar për të dy njësoj dhe bazuar në pretendimet shkollës i njëjti veprim automatic duhej të ndodhte dhe për nënën. Në rastin konkret, megjithatë, diferenca e trajtimit shfaqet ndërmjet dy prindërve të të njëjtit fëmijë: nëna, të cilës fëmija i është lënë për rritje dhe edukim, vazhdon të ketë akses, ndërsa babai, pas zgjidhjes së martesës dhe ndryshimit të statusit të tij familjar e civil, e ka humbur këtë akses. Kjo situatë e vendos ankuesin në një pozitë më pak të favorshme në raport me prindin tjetër për sa i përket marrjes së informacionit mbi arsimimin e fëmijës.

Në vlerësimin e kësaj diference, Komisioneri mban në konsideratë edhe nenin 158 të Kodit të Familjes, sipas të cilit prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës, si dhe nenet për përgjegjësinë prindërore, të cilat e lidhin këtë përgjegjësi me kujdesin, edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Për rrjedhojë, fakti që fëmija është lënë për rritje dhe edukim njërit prind nuk mund të interpretohet automatikisht si humbje e çdo të drejte të prindit tjetër për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në çështjet që lidhen me edukimin e fëmijës, në mungesë të një kufizimi të shprehur nga gjykata.

Në këto rrethana, Komisioneri çmon se ankuesi ka paraqitur një tërësi faktesh që krijojnë prezumimin e ekzistencës së diskriminimit. Konkretisht, ai ka provuar ekzistencën e një të drejte të mëparshme aksesi në SMIP, ndërprerjen e saj në datën e marrjes formë të prerë të vendimit të divorcit, trajtimin e ndryshëm nga prindi tjetër, lidhjen që vetë ZVAP Kamëz ka bërë ndërmjet ndërprerjes dhe mungesës së "*kujdestarisë ligjore*", si dhe faktin që shpjegimi i mëvonshëm për

[11] Të dhëna të disponuara në kuadër të ankesës nr. 104 regj/2026, të ankuesit kundër Shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi"

karakterin automatik të ndërprerjes nuk mbështetet nga sqarimi teknik i AKSHI-t. Në kushtet kur pala ankuese ka paraqitur këto fakte, barra e provës i kalon subjektit të paditur për të provuar se trajtimi i ndryshëm nuk ka ardhur për shkak të një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja.

Komisioneri vlerëson se, mosveprimi i ZVAP Kamëz për rikthimin e aksesit të ankuesit në sistemin SMIP nuk rezulton të jetë mbështetur në një bazë ligjore të parashikuar nga legjislacioni në fuqi apo nga rregullat që përcaktojnë funksionimin dhe administrimin e këtij sistemi. Për të shmangur përgjegjësinë, ZVAP ka deklaruar se ndryshimi i aksesit të ankuesit kishte ndodhur në mënyrë automatike dhe që nuk ishte përgjegjësi apo kompetencë e Shkollës apo ZVAP-së, ndërkohë që, bazuar në shkresën e AKSHI-t[12], një ndryshim i tillë nuk mund të ndodhte teknikisht në mënyrë automatike.

ZVAP ka rolin e monitorimit dhe mbështetjes teknike për shkollat në juriksion të saj. Ajo udhëzon administratorët e shkollave për zbatimin e funksionaliteteve të sistemit dhe ndërhyn në raste kur problematika nuk zgjidhet në nivel shkolle.

Në hierarkinë e institucioneve të arsimit parauniversitar, ZVAP (Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar) ka rolin e mbikëqyrësit dhe autoritetit vendimmarrës kur shkolla nuk mundet ose nuk ka kompetencën teknike për të zgjidhur rastin.
Lidhur me heqjen e aksesit të njërit prind në SMIP, ZVAP shërben si instanca që verifikon nëse kërkesa për heqje aksesi është në përputhje me ligjin. Nëse shkolla është në dyshim për një vendim gjykate (p.sh. nëse vendimi specifikon kufizimin e të drejtës për informim), ajo ia delegon rastin sektorit ligjor të ZVAP-së për interpretim.
Nëse administratori i shkollës has vështirësi teknike për të bërë "shkëputjen" (unlink) e prindit, ai i drejtohet Specialistit të SMIP në ZVAP. ZVAP ka akses më të lartë në sistem se shkolla dhe mund të ndërhyjë në databazë për të korrigjuar ose fshirë lidhjet e gabuara prind-fëmijë.

Përgjegjësia e ZVAP (Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar) është të veprojë si organi epror kontrollues dhe korrigjues.

Në këtë drejtim, është me rëndësi edhe standardi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit marrëdhënia ndërmjet prindit dhe fëmijës përbën "*jetë familjare*" në kuptim të nenit 8 të Konventës dhe kjo marrëdhënie nuk përfundon për shkak të ndarjes ose divorcit. Në çështjen Ciliz[13] kundër Holandës, Gjykata ka theksuar se lidhja familjare ndërmjet prindit dhe fëmijës nuk ndërpritet nga fakti që prindërit ndahen ose divorcohen dhe se autoritetet kanë detyrime pozitive për të mundësuar vazhdimin e marrëdhënies familjare pas divorcit. Gjykata ka nënvizuar gjithashtu rëndësinë e përfshirjes së prindit në proceset vendimmarrëse që prekin marrëdhënien e tij familjare me fëmijën.

[12] Administruar në kuadër të ankesës z. K kundër Shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi".
[13] CILIZ v. THE NETHERLANDS

Po kështu, në çështjen Paparrigopoulos[14] kundër Greqisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në shqyrtimin e një diference trajtimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ka vlerësuar se diferenca ndërmjet prindërve duhet të mbështetet në arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe se duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm proporcionaliteti ndërmjet diferencës së trajtimit dhe qëllimit të ndjekur. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8, pasi përjashtimi i babait nga ushtrimi i përgjegjësisë prindërore nuk kishte një raport të arsyeshëm proporcionaliteti me qëllimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

Ky standard është i zbatueshëm edhe në rastin objekt shqyrtimi, jo për të zëvendësuar kuadrin e brendshëm shqiptar, por për të orientuar interpretimin e parimit të barazisë dhe të respektimit të jetës familjare. Në rastin konkret, diferenca e trajtimit të ankuesit nuk rezulton të jetë mbështetur në një vlerësim individual të interesit të fëmijës, por në një kriter të njëanshëm dhe të pambështetur në ligj administrativ të zbatuar nga shkolla, (I njëjti qëndrim ësht mbajtur dhe nga ZVAP Kamëz) sipas të cilit vetëm prindi që ka "kujdestarinë ligjore" mund të ketë akses në SMIP. Një kriter i tillë, në kushtet kur përgjegjësia prindërore e ankuesit nuk është hequr ose kufizuar me vendim gjyqësor dhe kur vetë rregullat e SMIP-it i referohen personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, nuk rezulton të jetë një bazë e mjaftueshme dhe proporcionale për përjashtimin e tij.

Për më tepër, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim formal të mënyrës së aksesimit të një platforme elektronike. Pasoja konkrete e ndërprerjes së aksesit ka qenë kufizimi i mundësisë së ankuesit për të marrë informacion mbi arsimimin dhe ecurinë shkollore të fëmijës së tij dhe, për rrjedhojë, kufizimi faktik i pjesëmarrjes së tij në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Për këtë arsye, pasoja e trajtimit të pafavorshëm duhet të vlerësohet në lidhje të drejtpërdrejtë me pozitën juridike të ankuesit si prind dhe jo thjesht si përdorues i një sistemi informatik

Komisioneri vlerëson gjithashtu se në rastin konkret shkaqet e mbrojtura nuk kanë vepruar në mënyrë të izoluar. Gjendja martesore e ankuesit ka ndryshuar nga "i martuar" në "i divorcuar"; ky ndryshim ka sjellë ndryshimin e gjendjes familjare dhe civile; ndërsa pozita e tij si prind që nuk bashkëjeton me fëmijën dhe të cilit fëmija nuk i është lënë për rritje dhe edukim ka përcaktuar mënyrën se si ai është trajtuar nga shkolla. Për rrjedhojë, këto shkaqe janë të lidhura faktikisht dhe juridikisht me njëri-tjetrin dhe kanë bashkëvepruar në prodhimin e trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Për këtë arsye, Komisioneri çmon se situata objekt shqyrtimi vlerësohet sipas nenit 3/1, ku përcaktohet se, *çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.*

Në vlerësimin e intensitetit dhe pasojave të trajtimit diskriminues, Komisioneri mban në konsideratë edhe kohëzgjatjen e situatës. Ndërprerja e aksesit nuk ka qenë një episod i izoluar dhe i

[14] PAPARRIGOPOULOS v. GREECE

menjëhershëm, por ka vijuar për një periudhë të gjatë, pavarësisht kërkesave të përsëritura të ankuesit për sqarim dhe rivendosjen e aksesit. Ankuesi i është drejtuar Shkollës, ZVA Kamëz dhe institucioneve të tjera arsimore, duke kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion dhe zgjidhje, ndërsa situata nuk është korrigjuar. Kjo kohëzgjatje ka rëndësi në vlerësimin e pasojave reale të trajtimit të pafavorshëm dhe të rëndësisë së cenimit të së drejtës së ankuesit për të marrë informacion mbi arsimimin e fëmijës.

Në këto kushte, Komisioneri çmon se ankuesi ka provuar një trajtim më pak të favorshëm në raport me prindin tjetër të fëmijës dhe ka paraqitur fakte të mjaftueshme që krijojnë një prezumim të lidhjes së këtij trajtimi me shkaqet e mbrojtura. Nga ana tjetër, ZVAP Kamëz, në cilësinë e palës kundër të cilës është bërë ankesa, nuk ka arritur të provojë se diferenca në trajtim ka ardhur për një arsye objektive, të ligjshme, relevante dhe proporcionale, të pavarur nga shkaqet e mbrojtura.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se ndërprerja e aksesit të z. A. K në sistemin SMIP dhe mohimi i mundësisë së tij për t'u informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi ecurinë shkollore të vajzës së tij nuk përbëjnë një pasojë thjesht teknike të funksionimit të sistemit, por një trajtim më pak të favorshëm të tij në raport me prindin tjetër, i cili lidhet me pozitën e tij si prind i divorcuar, me gjendjen e tij familjare dhe martesore, me ndryshimin e gjendjes së tij civile dhe me mënyrën se si shkolla ka vlerësuar ushtrimin e përgjegjësisë së tij prindërore.

Në funksion të një vlerësimi të plotë, Komisioneri çmon se natyra e ndërthurur e shkaqeve të konstatuara duhet të pasqyrohet edhe në përfundimin e vendimit, pasi ankuesi nuk është trajtuar më pak favorizueshëm thjesht për shkak të faktit se është prind, por për shkak të pozitës së tij specifike si prind pas zgjidhjes së martesës, i cili nuk bashkëjeton me fëmijën dhe të cilit fëmija i është lënë nënës për rritje dhe edukim. Kjo pozitë është pikërisht ajo që e ka vendosur ankuesin në një situatë të ndryshme nga prindi tjetër dhe ka shërbyer si bazë për kufizimin e aksesit të tij në informacionin shkollor.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se është provuar lidhja shkakësore ndërmjet trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesit dhe shkaqeve të mbrojtura të "përgjegjësisë prindërore", "përkatësisë prindërore", "gjendjes familjare ose martesore" dhe "gjendjes civile", në kuptim të nenit 1 dhe nenit 3 të LMD-së. Për rrjedhojë, trajtimi i ankuesit përmbush elementet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, sipas nenit 3/1, të LMD-së.

Në këto rrethana, ndonëse në fillim të shqyrtimit të ankesës ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri marrjen e masave ndaj ZVAP Kamëz, ndër të tjera, për ndalimin e menjëhershëm të diskriminimit, rikthimin e aksesit të tij në SMIP dhe garantimin e ushtrimit të qetë e pa pengesa të përgjegjësisë prindërore lidhur me arsimimin e vajzës së tij, gjatë seancës dëgjimore në kuadër të ankesës kundër Shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi", ai ka sqaruar se, në vijim të procedurës, fëmija i tij tashmë nuk është më pjesë e kësaj shkolle.

Në këto kushte, masa për rikthimin e aksesit në SMIP, për sa kohë fëmija nuk është më i regjistruar në këtë institucion arsimor, nuk paraqet më të njëjtin efekt praktik dhe aktual, pasi aksesi lidhet drejtpërdrejt me të dhënat dhe ecurinë shkollore të nxënësit në institucionin përkatës. Megjithatë, ky zhvillim i mëvonshëm nuk e zhbën dhe as nuk e bën të pabazuar konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit gjatë periudhës kur fëmija ishte pjesë e Shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi"**,** nuk e eliminon pasojën e shkaktuar nga ndërprerja e aksesit dhe, mbi të gjitha, nuk e përjashton nevojën për një vlerësim përfundimtar nga Komisioneri lidhur me ekzistencën ose jo të diskriminimit të pretenduar.

Në këtë kuptim, fakti që rrethana objektive ka ndryshuar gjatë shqyrtimit të ankesës mund të ndikojë në përshtatshmërinë e masës korrigjuese, por nuk mund të shërbejë si shkak për të mohuar ose relativizuar shkeljen e pretenduar dhe faktet e provuara për periudhën objektin e shqyrtimit.

Përfundimisht, Komisioneri çmon se pasojat e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të pësuara nga ankuesi kanë ardhur për shkak të karakteristikave të tij të mbrojtura nga LMD-ja dhe jo për shkak të një rrethane teknike, objektive dhe të pavarur nga këto karakteristika. Për këtë arsye, ZVAP Kamëz, me mosveprimet e saj, ka diskriminuar z. A. K për shkak të përgjegjësisë prindërore, përkatësisë prindërore, gjendjes familjare ose martesore dhe gjendjes civile, lidhur me ushtrimin e të drejtës së tij për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në çështjet që lidhen me arsimimin e fëmijës së tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre",* ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: *"Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës".*

Ligji nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e *diskriminimit në formë të rëndë,* të ankuesit z. A. K nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Paruniversitar Kamëz, për shkak të "*gjendjes martesore*", "*gjendjes civile*", "*përgjegjësisë prindërore*" dhe "*gjendjes familjare*".

2. ZVAP Kamëz të marrë masat e nevojshme ndaj Shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi", Tiranë, për zbatimin e njëtrajtshëm të kriterit të *ushtrimit të përgjegjësisë prindërore* në administrimin dhe ofrimin e informacionit arsimor të fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e SMIP, duke mos e kushtëzuar të drejtën e prindit për akses në informacionin arsimor të fëmijës me kriterin e "kujdestarisë ligjore", përveç rasteve kur një kufizim i tillë rezulton shprehimisht nga një vendim gjyqësor i formës së prerë ose nga një dispozitë ligjore.

3. Rekomandohet ZVAP Kamëz të marrë masa për parandalimin e përsëritjes së situatave të ngjashme në institucionet arsimore në juridiksionin e saj, duke garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave për aksesin e prindërve në informacionin arsimor të fëmijëve, në përputhje me parimin e përgjegjësisë prindërore, barazisë dhe mosdiskriminimit.

4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, ZVAP Kamëz, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)